



„Ipko Telecommunications“ L.L.C.  
Numri i biznesit - 70064420  
Drejtor – Robert ERZIN  
Ipko Telecommunications LLC  
Rr/Zija Shemsiu nr. 34, Lagjja Ulpiana  
Prishtinë

Ref:1807/836/LIC/ni

## VENDIM

*për ripërtitjen e licencës së KPM-së për Ipko Telecommunications LLC, me seli në Prishtinë*

---

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Ipko Telecommunications LLC është operatorë i shpërndarjes, i cili ishte licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audivizuale përmes sistemit kabllorë, me seli në Prishtinë. KPM, me datën 1 gusht 2008, ka marr vendim për dhënien e licencës për operatorë të shpërndarjes për Ipko Telecommunications LLC.
3. Me datën 1 gusht 2018, skadon afati i licencës së Ipko Telecommunications LLC, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidatit i ofrohet e drejta të kërkojë ripërtitjen e licencës në afat brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më 27 mars 2018, Departamenti i Licencimit, pranë Zyrës Ekzekutive të KPM-së, i ka njoftuar të gjithë të licencuarit lidhur me afatet dhe obligimet që parashihen me nenin 25 të Ligjit për KPM, për ripërtitje të Licencës së KPM-së.
5. Më 20 prill 2018, operatori i shpërndarjes Ipko Telecommunications LLC ka parashtruar kërkesën në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka shprehur interesimin për ripërtitje të Licencës së KPM-së.

## Arsyetimi

6. Operatori i Shpërndarjes Ipko Telecommunications LLC, ka parashtruar kërkesën për ripërtëritje të licencës së KPM-së brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe në pajtim të plotë me procedruat e përcaktuara administrative nga KPM.
7. Neni 25 i Ligjit për KPM-në, i cili thekson:

*“Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkëljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel privat për sa u përket kushteve dhe kritereve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Zyra Ekzekutive brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës”,*

krijon bazën ligjore që të ripërtëritet licencën e kandidatëve të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje në pajtim me ligjin për KPM.

## Vendim

8. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 1 gusht 2018, në pajtim me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në, merr vendim për ripërtëritjen e licencës së Ipko Telecommunications LLC, për të ushtruar veprimtarin e shpërndarjes së shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale në Republikën e Kosovës.
9. Licenca e KPM-së për operatorin e shpërndarjes Ipko Telecommunications LLC do të jetë e vlefshme në afat prej 10 (dhjetë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 1 gusht 2018.
10. Të gjitha parametrat e Licencës së KPM-së, shtrirja e rrjetit të operatorit të shpërndarjes Ipko Telecommunications LLC, si dhe lista e kanaleve sipas katalogut që është pjesë përbërëse e Licencës së KPM-së, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
11. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.

  
Muja FERATI  
Kryetar  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



01.08.2018  
datë